



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Njoftim Paraprak Përqendrimi

Rasti: Përfitim Kontrolli Nokia Corporation / Alcatel Lucent

Në datën 15 Maj 2015, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të pritshëm (i cili do të realizohet në bazë të një oferte publike) në bazë të “Memorandumit të Mirëkuptimit” e nënshkruar midis palëve Nokia Corporation dhe Alcatel-Lucent, më datë 15 Prill 2015. Ky transaksion ka si objekt kombinimin e veprimtarive të palëve e cila do të shkaktojë përfitim e kontrollit të plotë dhe të vetëm mbi shoqërinë Alcatel-Lucent nga shoqëria Nokia Corporation.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Nokia Corporation:** është një shoqëri shumëkombëshe me zyra qendrore në Finlandë dhe e kotuar në Bursat e Helsinkit dhe të New York-ut. Nokia është e organizuar në disa njësi biznesi si Nokia Netëorks (HERE) dhe Nokia Technologies.
- **Alcatel-Lucent** : është një shoqëri me zyra qendrore në Francë dhe e listuar në Bursat e Euronext dhe të New York-u. Biznesi i Alcatel-Lucent është i organizuar në njësitë operative të Aksesit (Access) dhe Rrjetit Qendror (Core Networking).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10, pika 1) shkronja b), 12, pika 1) dhe 2 , pika 1) shkronja a) të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al